



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 425/4 Prot.

Tiranë, më 02.02 2024

VENDIM
Nr. 10 datë 02.02 2024

“PËR
NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT
ME AKADEMINË NDËRKOMBËTARE TË NUTRICIONIT KLINIK (ANNUK)”

Mbështetur në nenin 3, pika 4, gërma “c” dhe nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 ‘Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë’, në nenin 20, pika “s” të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës si dhe në Vendimin e Rektoratit nr. 12 datë 02.02.2024, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 02.02.2024,

V E N D O S I:

1. Miratimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Akademisë Ndërkombëtare të Nutricionit Klinik (ANNuK).
2. Ky Vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në faqen zyrtare të institucionit.
3. Ngarkohet për zbatimin dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nënshkrimit Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr. Agron KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SPORTEVE
TË TIRANËS

Nr.....prot

Datë _____ 2024

AKADEMIA NDËRKOMBËTARE
E NUTRICIONIT KLINIK

Nr.....prot

Datë _____ 2024

DRAFT
MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
DHE
AKADEMISË NDËRKOMBËTARE TË NUTRICIONIT KLINIK

E lidhur sot më datë _____, _____, 2024 ndërmjet:

UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, me NIPT K51712019Q, me adresë Rruga “Muhamet Gjollesha”, Tiranë, përfaqësuar nga **Rektori Prof.Dr. Agron KASA** këtu e më poshtë **UST**

dhe

AKADEMISË NDËRKOMBËTARE TË NUTRICIONIT KLINIK, me NIPT **L51503455E**, me adresë Rr.Jordan Misja, nr.2,ap.1, Tiranë, përfaqësuar nga **Drejtori ekzekutiv znj. Albana PRIFTAJ** këtu e më poshtë **ANNuK**.

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Objekti

Objekt i kësaj Marrëveshje është bashkëpunimi për mbi bazen e barazize dhe perfitimin e perbashket ne cdo fushe te kesaj marreveshje.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi mes dy subjekteve për realizimin e veprimtarive të përbashkëta informuese, promovuese dhe marketing, me qëllim zgjidhjen e problematikave, rritjen e imazhit të institucioneve respektive si dhe sensibilizimin e qytetarëve rreth projekteve të përbashkëta të dy institucioneve në **shkencën e nutricionit klinik**.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo Marrëveshje është mbështetur në ligjin nr. 80/2015 “Për e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 79/2017 “Për Sportin”.

Neni 4
Universiteti i Sporteve të Tiranës

- Angazhohet të ofrojë studentë të talentuar, ambiciozë dhe me interes për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive të tyre në shkencën e nutricionit klinik.
- Angazhohet të pasqyrojë të dhënat e ANNUK si dhe të mundësive të punësimit / trajnimit të ofruar nga kjo organizatë në portalin e Qendrës së Karrierës së UST-së;
- Angazhohet të ftoj përfaqësues të ANNUK në aktivitetet akademike, shkencore, kulturore dhe sportive.
- Angazhohet që në bashkëpunim me ANNUK të organizojme sesione informimi dhe seminare kualifikimit për studentët dhe stafin e Universitetit të Sporteve të Tiranës.

Neni 5
Akademia Ndërkombëtare të Nutricionit Klinik

- Angazhohet të ftojë studentë të Universitetit të Sporteve të Tiranës në aktivitete të ndryshme të saj.
- Angazhohet të zhvillojë Eorkshopë, seminare, aktivitete të ndryshme me interes reciprok.
- Angazhohet që në bashkëpunim me **Universitetin e Sporteve të Tiranës** të organizojme sesione informimi dhe seminare kualifikimit për studentët dhe stafin e Universitetit të Sporteve të Tiranës.

Neni 6
Autoriteti dhe afati i zbatimit

Autoritetin për të zbatuar këtë marrëveshje e ka **Universiteti i Sporteve të Tiranës** dhe **Akademisë Ndërkombëtare të Nutricionit Klinik**. Kjo marrëveshje është për një afat të papërcaktuar.

Neni 7
Mirëkuptimi dhe vullneti për bashkëpunim

1. **Universiteti i Sporteve të Tiranës** dhe ANNUK shprehin mirëkuptimin dhe vullnetin për një bashkëpunim të frytshëm dhe rezultativ.
2. Ngarkohen strukturat përkatëse të **Universitetit dhe ANNUK** për hartimin e planeve të përbashkëta për realizimin e angazhimeve të palëve.

Neni 8
Nënshkrimi

Kjo Marrëveshje e lidhur midis **Universitetit i Sporteve të Tiranës** dhe **Akademisë Ndërkombëtare të Nutricionit Klinik** mbahet në 2 (dy) kopje origjinale dhe ka fuqi zbatuese nga punonjësit e tyre.

Marrëveshja përbëhet nga tre fletë dhe secila prej tyre nënshkruhet nga titullarët e institucioneve.

Vendi dhe data e nënshkrimit

Tiranë më : .../02/2024

PËR

**UNIVERSITETIN E SPORTEVE
TË TIRANËS**

REKTORI
Prof.Dr. Agron KASA

PËR

**AKADEMINË NDËRKOMBËTARE
TË NUTRICIONIT KLINIK**

DREJTOR EKZEKUTIV
D.Sh.M Albana PRIFTAJ (DAKA)